



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**Njoftim Përqendrimi**

Rasti: Eurokontakt Sh.p.k / Lion Real Estate Albania Sh.p.k / Lion Retail Holding S.A.R.L

Në datën 22 Korrik 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes për Shitjen dhe Blerjen e Lion Real Estate Albania Sh.p.k” e nënshkruar ndërmjet palëve shoqërisë Eurokontakt Sh.p.k (Blerësi) dhe shoqërisë Lion Retail Holding S.A.R.L (aksionari kontrollues i shoqërisë Lion Real Estate Albania Sh.p.k) me objekt përfitim të kontrollit të plotë nëpërmjet përfitimit të 100% kapitalit themeltar në shoqërinë Target Lion Real Estate Albania Sh.p.k.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Eurokontakt Sh.p.k:** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit Shqiptar me veprimtari në fushën e shpërndarjes me shumice të pijeve jo-alkoolikë freskuese si dhe shitje e pajisjeve elektronike, etj.
- **Lion Real Estate Albania Sh.p.k:** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit Shqiptar me veprimtari në fushën e dhënies me qira të magazinës industriale në pronësi të saj. Shoqëria zotërohet nga aksioner i huaj shoqëria Lion Retail Holding S.A.R.L.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2 , 10, pika 1.b) dhe 12 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**